



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 14 tetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për
Dorëzimin e Përgjigjeve ndaj Parashtrimeve F02620, F02625 dhe F02633**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(4)(c) dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 9(5)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 7 tetor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi listën e dëshmitarëve për periudhën 18 nëntor 2024 deri më 30 janar 2025 ("Lista e Dëshmitarëve").¹

2. Më 8 tetor 2024, ZPS-ja dorëzoi mocionin për pranimin e provave të dëshmitarëve W02586, W03873, W04264, W04393, W04401, W04679 dhe W04747 sipas rregullës 154 ("Mocioni i Parë sipas Rregullës 154").²

3. Më 11 tetor 2024, ZPS-ja dorëzoi mocionin për pranimin e provave të dëshmitarëve W04826, W04874 dhe W04875 sipas rregullave 138, 149 dhe 154 dhe kërkesë në lidhje me to ("Mocioni për Ekspertët").³

4. Më 11 tetor 2024, ekipet e Mbrojtjes së katër të akuzuarve (bashkërisht, "Mbrojtja") dorëzuan bashkërisht kërkesë për zgjatjen e afatit për dorëzimin e përgjigjeve ndaj Listës së Dëshmitarëve, Mocionit të Parë sipas Rregullës 154 dhe Mocionit për Ekspertët (bashkërisht, "Mocionet e ZPS-së") ("Kërkesa").⁴

¹ F02620, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Listës së Dëshmitarëve për Periudhën 18 nëntor 2024 deri më 30 janar 2025*, 7 tetor 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F02620/RED).

² F02625, Prokurorja e Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W02586, W03873, W04264, W04393, W04401, W04679 dhe W04747 sipas Rregullës 154*, 8 tetor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-7, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 9 tetor 2024, F02625/RED).

³ F02633, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W04826, W04874, dhe W04875 sipas Rregullave 138, 149, dhe 154 dhe Kërkesë në lidhje me To*, 11 tetor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-3, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F02633/RED).

⁴ F02638, *Mbrojtja, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Përgjigjeve ndaj Parashtrimeve F02620, F02625 dhe F02633*, konfidenciale, 11 tetor 2024 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 14 tetor 2024, F02638/RED).

II. PARASHTRIMET

5. Mbrojtja kërkon: (i) zgjatjen e afatit me dhjetë (10) ditë për dorëzimin e vlerësimeve për kohën që i nevojitet për marrjen në pyetje dhe kundërshtimeve ndaj provave materiale të propozuara për shtatë nga dëshmitarët e Listës së Dëshmitarëve dhe që përmenden në Mocionin e Parë sipas Rregullës 154;⁵ (ii) zgjatjen e afatit me shtatë (7) ditë për t'u përgjigjur ndaj Mocionit të Parë sipas Rregullës 154;⁶ dhe (iii) zgjatjen e afatit me dhjetë (10) ditë për dorëzimin e vlerësimeve për kohën që i nevojitet për marrjen në pyetje të tre dëshmitarëve ekspertë të përfshirë në Listën e Dëshmitarëve dhe Mocionin për Ekspertët.⁷ Mbrojtja kërkon gjithashtu zgjatjen e afatit me pesëmbëdhjetë (15) ditë për t'u përgjigjur ndaj Mocionit për Ekspertët.⁸

6. Mbrojtja argumenton se Kërkesa është bërë në kohë pasi u dorëzua pak pas njoftimit të Mbrojtjes për Mocionet e ZPS-së dhe në kohë të mjaftueshme para afatit për përgjigjet e Mbrojtjes.⁹ Gjithashtu, Mbrojtja argumenton se ekzistojnë arsye të vlefshme për ta miratuar Kërkesën, duke marrë parasysh vëllimin e madh të materialit që duhet rishikuar dhe analizuar.¹⁰ Sipas Mbrojtjes, zgjatja e afatit është e nevojshme për të përgatitur përgjigje kuptimplota¹¹ dhe do t'i mundësonte Mbrojtjes të dorëzojë përgjigje përmbledhëse për ta përshpejtuar procesin.¹² Bazuar në sa më lart, Mbrojtja thekson se zgjatja e afatit është e nevojshme për të garantuar të drejtat e të akuzuarve për kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tyre.¹³ Gjithashtu, Mbrojtja argumenton se mjete juridik që kërkohet në Kërkesë është i arsyeshëm e i kufizuar dhe nuk i shkakton dëm ZPS-së.¹⁴

⁵ Kërkesa, para. 2(i), 3(i).

⁶ Kërkesa, para. 2(ii), 3(i).

⁷ Kërkesa, para. 2(i), 3(i).

⁸ Kërkesa, para. 2(iii), 3(ii).

⁹ Kërkesa, para. 5.

¹⁰ Kërkesa, para. 7.

¹¹ Kërkesa, para. 6, 7.

¹² Kërkesa, para. 10.

¹³ Kërkesa, para. 9.

¹⁴ Kërkesa para. 11.

7. Mbrojtja bëri të ditur se, në varësi të një kushti, ZPS-ja nuk kundërshton zgjatjet e kërkuara të afateve.¹⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Në bazë të rregullës 9(5)(a), nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, paneli mund të zgjasë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej panelit.

IV. DISKUTIM

9. Trupi Gjykses konstaton se Kërkesa është bërë në kohë pasi është parashtruar në kohë të mjaftueshme para përfundimit të afateve përkatëse.

10. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja ka treguar arsye të vlefshme për zgjatje të kufizuar të afatit, duke marrë parasysh, veçanërisht: (i) vëllimin e madh të materialit që duhet rishikuar dhe analizuar, posaçërisht duke pasur parasysh provat e shumta materiale të propozuara dhe materialin kompleks në lidhje me dëshmitarët ekspertë të propozuar;¹⁶ dhe se (ii) mjeti juridik i kërkuar nuk i shkakton dëm ZPS-së pasi zgjatja e kërkuar e afatit lejon kohë të mjaftueshme për kundërpërgjigje nga ZPS-ja.¹⁷ Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e ka informuar ZPS-së *inter partes* për qëndrimet paraprake që ka në lidhje me dëshmitarët ekspertë.¹⁸

11. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se, pas konsultimit *inter partes*, ZPS-ja nuk kundërshton zgjatjet e kërkuara të afateve, me kusht që Mbrojtja të dorëzojë vlerësimet për kohën që i nevojitet për marrjen në pyetje të dëshmitarëve ekspertë deri më 25 tetor 2024.¹⁹

¹⁵ Kërkesa, para. 4.

¹⁶ *Shih* Kërkesën, para. 7.

¹⁷ *Shih* Kërkesën, para. 11.

¹⁸ Kërkesa, para. 11.

¹⁹ Kërkesa, para. 3(i).

12. Në bazë të sa më lart, Trupi Gjykses miraton kërkesën dhe (i) zgjat afatin e Mbrojtjes për t'u përgjigjur ndaj Mocionit të Parë sipas Rregullës 154 dhe për të dorëzuar vlerësimet për kohën që i nevojitet për marrjen në pyetje dhe kundërshtimet ndaj provave materiale të propozuara për shtatë dëshmitarët përkatës, si dhe për dorëzimin e vlerësimeve për kohën që i nevojitet për marrjen në pyetje të tre dëshmitarëve ekspertë, deri **të premten, 25 tetor 2024**; si dhe (ii) zgjat afatin e Mbrojtjes për t'u përgjigjur ndaj Mocionit për Ekspertët dhe për të dorëzuar kundërshtimet ndaj provave materiale të propozuara të tre dëshmitarëve ekspertë, deri **të premten, 8 nëntor 2024**.

V. VENDIM

13. Për arsyet e sipërpërmendura, Trupi Gjykses:

a) **MIRATON** Kërkesën e Mbrojtjes; dhe

b) **ZGJAT** afatin e Mbrojtjes:

- i. për të dorëzuar përgjigjen ndaj Mocionit të Parë sipas Rregullës 154, vlerësimet për kohën që i nevojitet për marrjen në pyetje dhe kundërshtimet ndaj provave materiale të propozuara për shtatë dëshmitarët përkatës, si dhe vlerësimet për kohën që i nevojitet për marrjen në pyetje të tre dëshmitarëve ekspertë, deri **të premten, 25 tetor 2024**; dhe
- ii. për të dorëzuar përgjigjen ndaj Mocionit për Ekspertët dhe kundërshtimet ndaj provave materiale të propozuara të tre

dëshmitarëve ekspertë, deri të premten, 8 nëntor 2024.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E hënë, 14 tetor 2024

Në Hagë, Holandë.